



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 230, datë 12.11.2019

**PËR CAKTIMIN E LIMITIT TË KARBURANTIT PËR AUTOMJETET NË  
DISPOZICION TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenin 95 dhe 96, pika 5 e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në Vendimitn Nr 11, datë 06/04/2010 të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe të përgjegjësiive të ngarkuara, për detyrat që ato kryejnë, si dhe për mirëfunksionimin normal të punës, për Këshillin e Lartë të Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Konsumi mujor i karburantit, për automjetin në dispozicion të Kryetarit të Këshillit Lartë të Prokurorisë, do të jetë pa limit.
2. Limiti mujor i konsumit të karburantit për automjetin në dispozicion të ZvKryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, do të jetë 200 litra për çdo muaj.
3. Limiti mujor i konsumit të karburantit për çdo automjet në dispozicion të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, do të jetë 150 litra, për çdo muaj.
4. Për automjetet në dispozicion të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilët e kanë vendbanimin jashtë Qarkut Tiranë, limiti mujor i konsumit të karburantit, do të jetë 200 litra për çdo muaj.
5. Për automjetet e tjera në dispozicion të administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, (limiti) shpenzimi do të jetë sipas normativës së konsumit për çdo automjet dhe km të kryera sipas fletë udhëtimeve të mbajtura, referuar distancave kilometrike ndërqytetëse.

6. Të bëhet rimbursimi i shpenzimeve të karburantit për Kryetarin, zv. Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në vlerën në lekë për sasinë 150 litra në muaj për periudhën 1 janar 2019 deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, pranë institucionit.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETARI  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETARI  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
ARBEN DOLLAPAJ**

**ANËTAR  
BESNIK CANI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**VATË STAKA**

**KOSTAQ BELURI**

**NURIHAN SEITI**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**SANDËR BECI**

**ESMERALDA KESHI**

**TARTAR BAZAJ**